

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Mars 2020

Tiranë, më 23 Prill 2020: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Mars 2020, janë 272.514.


Krahasuar me Mars 2019, ky tregues rezulton me rënie 61,8 %. Në Mars 2020, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 95.321. Krahasuar me Mars 2019, ky numër ka rënë me 66,4 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë përgjatë tre muajve të parë 2020 është 573.723, duke rënë me 17,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në Mars 2020, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Anglia ka pasur rritjen më të madhe, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur SHBA, krahasuar me Mars 2019.

Përgjatë tre muajve të parë 2020, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Anglia ka pasur rritjen më të madhe me 27,0 % ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur SHBA me 36,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Mars 2020, janë 284.929 duke shënuar një rënie me 60,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2020, janë 175.627. Krahasuar me Mars 2019, ky numër ka rënë 60,5 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2020, janë 109.302, krahasuar me Mars 2019, ka pësuar rënie me 61,5 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë përgjatë tre muajve të parë 2020, është 1.100.290 duke rënë 12,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Mars 2019	Mars 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2019	Janar-Mars 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	712.983	272.514	-61,8	1.817.722	1.582.966	-12,9
Shqiptarë	429.073	177.193	-58,7	1.122.695	1.009.243	-10,1
Të Huaj	283.910	95.321	-66,4	695.027	573.723	-17,5
Dalje Gjithsej	728.817	284.929	-60,9	1.982.085	1.767.352	-10,8
Shqiptarë	444.828	175.627	-60,5	1.249.803	1.100.290	-12,0
Të Huaj	283.989	109.302	-61,5	732.282	667.062	-8,9

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Mars 2019	Mars 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2019	Janar-Mars 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	79.389	29.174	-63,3	203.927	177.454	-13,0
Maqedonia e Veriut	45.464	15.442	-66,0	104.898	87.706	-16,4
Greqi	45.385	15.183	-66,5	108.960	92.032	-15,5
Itali	21.594	4.793	-77,8	58.283	44.269	-24,0
Angli	1.861	2.831	52,1	11.407	14.491	27,0
Mali i zi	34.889	12.150	-65,2	80.499	70.377	-12,6
Poloni	582	260	-55,3	1.349	1.337	-0,9
SHBA	6.741	1.369	-79,7	13.527	8.646	-36,1
Spanjë	494	156	-68,4	1.249	1.120	-10,3
Gjermani	2.707	1.335	-50,7	7.951	7.633	-4,0
Zvicër	1.437	374	-74,0	3.989	3.234	-18,9
Të tjera	43.367	12.254	-71,7	98.988	65.424	-33,9
Gjithsej	283.910	95.321	-66,4	695.027	573.723	-17,5

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Mars 2019	Mars 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2019	Janar-Mars 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	283.910	95.321	-66,4	695.027	478.402	-31,2
I. Personale	276.068	88.496	-67,9	674.805	462.711	-31,4
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	262.419	83.473	-68,2	643.145	442.786	-31,2
2. Trajtim shëndetësor	71	49	-31,0	137	95	-30,7
3. Qëllime fetare	39	17	-56,4	195	73	-62,6
4. Udhëtarë transit	13.539	4.957	-63,4	31.328	19.757	-36,9
II. Biznes dhe profesionale	7.842	6.825	-13,0	20.222	15.691	-22,4

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Mars 2019	103.433	28.298	581.252	102.288	36.464	590.065
Mars 2020	38.304	10.956	223.254	38.323	8.514	238.092,0
Ndryshimi vjetor (%)	-63,0	-61,3	-61,6	-62,5	-76,7	-60,0
Janar-Mars 2019	294.662	72.586	1.450.474	309.427	104.959	1.567.699
Janar-Mars 2020	251.434	59.996	1.271.536	266.913	78.286	1.422.153
Ndryshimi vjetor (%)	-14,7	-17,3	-12,3	-13,7	-25,4	-9,3

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Tre-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.